



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
12.12.2014

NR. VENDIMI 15
15.06.2015

VENDIM

PËR KONFISKIM E PASURIE

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e përbërë prej:

Luan HASNEZIRI - Gjyqtar

Iliriana OLLDASHI - Gjyqtare

Idriz MULKURTI - Gjyqtar

asistuar nga sekretare Lavdie HYSAJ, në Tiranë, sot me datë 15.06.2015, në seancë gjyqësore publike përfundoi çështjen civile me palë:

PADITËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, përfaqësuar nga prokurorët Besnik Muçi dhe Gentian Trenova.

I PADITUR: 1. H.M., i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx dhe banues në Rr: "xxx", Pall xxx, Shkalla xxx, Apartamenti xxx, xxx, aktualisht me vendqëndrim në xxx, në adresën "xxx", xxx, përfaqësuar në gjykim në bazë të prokurës së posaçme nr. xxx, Rep, nr. xxx Kol, datë xxx, të lëshuar personalisht nga i padituri H.M., nga avokatët Sh.M. dhe F.Gj.

2. E.M, i biri i xxx dhe i xxx, i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx në në Rr: “xxx”, Pall xxx, Shkalla xxx, Apartamenti xxx, xxx, aktualisht me vendqëndrim në xxx, në *adresën* “xxx”, xxx, përfaqësuar në gjykim në bazë të prokurës së posaçme nr. xxx, Rep, nr. xxx Kol, datë xxx, të lëshuar personalisht nga i padituri E.M., nga avokatët Sh.M. dhe F.Gj.

OBJEKTI: Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

1. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit H.M.M.;
2. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
3. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
4. Të shumës prej xxx euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
5. Të shumës prej xxx euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
6. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
7. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
8. Të shumës prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 12, 21, 23 dhe 24 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit*”

dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, administroi provat, dëgjoji në diskutimin përfundimtar prokurorin, i cili kërkoi:

1. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të shumave të llogarive bankare të mëposhtëme:

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit H.M.M., në shumën xxx Euro.

- Shumën prej xxx Euro nga llogaria me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., e cila ka vlerën totale, në shumën xxx Euro.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

2. Kthimin të paditurve të shumave të llogarive bankare të mëposhtëme.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

- Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., në shumën xxx Euro.

- Shumën prej xxx Euro nga llogaria me nr. xxx në Bankën xxx Bank, në emër të shtetasit E.H.M., e cila ka vlerë totale shumën xxx Euro

3. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Shërbimi Përmbarimor, ndërsa për Administrimin e pasurive Z. K.Xh., e cili është Administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave xxx.

Gjykata pasi dëgjoji në diskutimin përfundimtar përfaqësuesin me prokurë të posaçme të të paditurve H.M. dhe E.M., avokat Sh.M., i

cili kërkoi rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurive, si të pabazuar në prova e ligj;

VËREN:

1. Me datë xxx, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, xxx, është paraqitur kërkesa me objekt konfiskimin e pasurive, konkretisht të shumave të parave që ndodhen të depozituara në disa banka të nivelit të dytë, në Shqipëri, në emër të të paditurve H.M. dhe E.M., shuma të cilat janë cituar, me hollësi në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Në lidhje me gjykimin e zhvilluar kundër të paditurve H.M. dhe E.M., gjykim i cili zhvillohet, për aq sa është e mundur, në bazë të rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, gjykata çmon të sqarojë se, gjykimi i ndaj tyre u zhvillua në mungesë të tyre, pavarësisht nga fakti se, të dy të paditurit, personalisht, kanë lëshuar prokurë të posaçme noteriale, në të cilën deklarohet se, interesat e tyre në këtë gjykim, do të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre të posaçëm, avokatët Sh.M. dhe F.Gj.

3. Meqenëse të paditurit H.M. dhe E.M., nuk kishin dijeni për datën dhe orën e gjykimit që po zhvillohej kundër tyre, pavarësisht se ata kishin lëshuar prokurë të posaçme, sipas të cilës interesat e tyre në këtë gjykim do të mbroheshin nga avokatët e zgjedhur, personalisht prej tyre, gjykata me qëllim garantimin e parimit kushtetues dhe ligjor, sipas të cilit kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet, bëri njoftimin e të dy të paditurve për zhvillimin e gjykimit kundër tyre, me objekt konfiskimin e shumave të caktuara të parave që ndodhen të depozituara, në emër të tyre, në disa banka të nivelit të dytë, shuma që janë përcaktuar konkretisht në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

4. Njoftimi i të paditurve H.M. dhe E.M., u bë nga ana e gjykatës me anë të Letër Rekomandesë, me lajmërim marrje, meqenëse të dy të paditurit ishin me vendqëndrim në xxx, në adresë të ditur, konkretisht në adresën: “xxx”, xxx, dhe pas realizimit të njoftimit rezultoi se, të dy të paditurit kanë nënshkruar aktin e njoftimit me anë të rekomandesë, duke marrë njoftim rregullisht për gjykimin që po zhvillohej kundër tyre.

5. Në përfundim të procedurës së njoftimit, duke qenë se të paditurit H.M. dhe E.M. kanë marrë dijeni rregullisht për gjykimin që po zhvillohej kundër tyre dhe nuk u paraqitën në seancë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm të bërë me dije gjykatës, gjykata, në bazë të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të deklaroi mungesën e tyre dhe të vijojë gjykimin në prani të përfaqësuesve të tyre të posaçëm, të zgjedhur personalisht nga vetë të paditurit, të avokatëve Sh.M. dhe F.Gj.

6. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga ana e organit të prokurorisë, kjo

gjykatë, para se të argumentojë konkretisht, nëse ajo është e bazuar apo jo, çmon të bëj një analizë ligjore, në mënyrë të përmbledhur, të objektit dhe natyrës së këtij gjykimi, i cili, duhet thënë që në fillim se, është krejt i ndryshëm, nga gjykimi penal që ka si qëllim gjykimin e të pandehurit të akuzuar për një ose disa vepra penale dhe më pas, deklarimin e tij të pafajshëm ose fajtor dhe caktimin e një mase dhe lloji dënimi penal, në rastet kur ai deklarohet i fajshëm.

7. Gjykimi me objekt konfiskimin e pasurisë, i rregulluar me ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar, është një gjykim *“in rem”* ose mbi pasurinë, në ndryshim nga gjykimi penal që zhvillohet ndaj një të pandehuri, i rregulluar nga Kodi i Procedurës Penale, i cili, është një gjykim *“in personam”* ose mbi personin.

8. Në përputhje me këtë dallim themelor, vijojnë edhe dallime të tjera të rëndësishme, ndërmjet këtyre dy gjykimeve, ku, më kryesoret janë:

i. qëllimi i gjykimit penal ndaj të pandehurit (gjykimit in personam) është konkludimi nga ana e gjykatës, nëse ai është i pafajshëm ose i fajshëm dhe caktimi i një mase dhe lloji dënimi të parashikuar në ligj, nëse ai rezulton i fajshëm, ndërsa, qëllimi i gjykimit me objekt konfiskimin e pasurisëve (gjykimit in rem), është konfiskimi i pasurive të një personi, nëse, gjykata konkludon se, ka dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie që ai është përfshirë në një ose disa veprimtari kriminale, të cilat janë parashikuara, në mënyrë të shprehur në ligj, si dhe në qoftë se ky person nuk arrin që të provojë origjinën e ligjshme të pasurisë së tij;

ii. në gjykimin penal (in personam) barrën e provës *“unus probandi”* për të provuar fajësinë e të pandehurit e ka, në çdo rast, prokurori, ndërsa, në gjykimin me objekt konfiskimin e pasurisë (in rem) barra e provës është e ndarë, ndërmjet akuzës dhe personit kundër të cilit është paraqitur kërkesa për konfiskim, prokurori ka për detyrë që të provojë që ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie se, personi ka kryer një ose disa vepra penale të parashikuara, shprehmisht në ligj, si dhe gjendja pasurore e personit, nuk i përgjigjet, në mënyrë të hapur, nivelit të tij të të ardhurave, ndërsa, personi kundër të cilit është paraqitur kërkesa për konfiskimin e pasurisë, ka për detyrë që të provojë origjinën e ligjshme të pasurisë e cila kërkohet të konfiskohet.

iii. niveli i të provuarit në gjykimin penal (in personam), është më i lartë se, niveli i të provuarit në gjykimin me objekt konfiskimin e pasurisë ose gjykimin in rem, sepse, në rastin e gjykimit penal, prokurori ka detyrimin që të provojë fajësinë e të pandehurit, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa, në rastin e gjykimit in rem, prokurori ka detyrimin që të provojë brenda probalitetit të mundësive që, personi dyshohet se ka kryer një ose disa vepra penale nga ato që parashikohen, në mënyrë të shprehur nga ligji, si dhe niveli i të ardhurave

të këtij personi, nuk i përgjigjet dukshëm mundësive të tij ekonomike dhe standartit të tij të jetësës.

9. Në përputhje me këto parime të *gjykimit in rem*, të pasqyruara nga ana gjykata, në pikën 8 më sipër, të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, tani është momenti që të analizohet nga ana ligjore, në bazë të provave dhe akteve të shqyrtuara:

i. nëse, nga ana e akuzës është plotësuar barra e provë, për pjesën që asaj i takon të provojë, pra, nëse, nga ana e akuzës u arrit që të provohej në gjykim që për të paditurit, vetë personalisht apo si persona të lidhur, ekzistojnë dyshime të arsyeshme që kanë kryer një ose disa vepra penale, të cilat parashikohen, shprehimisht, nga ligji nr. 10192, datë 03.12.2009, dhe nëse, nga ana e të paditurve nuk u justifikua, në mënyrë të dukshme, niveli i të ardhurave të tyre;

ii. nëse, nga ana e të paditurve H.M. dhe E.M., është plotësuar barra e provës, për pjesën që atyre iu takon, pra, nëse të paditurit arritën që të provonin në gjykim, brenda probabilitetit të mundësive, origjinën e ligjshme të pasurive që kërkohen të konfiskohen.

10. Bazuar në aktet dhe provat e shqyrtuara, gjykata konkludon se, nga ana e akuzës, *për masën e pasurisë që ajo kërkoi që të konfiskohet*, u arrit që të provohet, pjesa e saj e barrës së provës, pra, akuza arriti që të provojë që për të paditurit H.M. dhe E.M., ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicje, që kanë kryer një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, të ndryshuar, dhe konkretisht veprën penale të: “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*”, të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, si dhe të paditurit zotërojnë pasuri që nuk i përgjigjen, në mënyrë të dukshme, nivelit të të ardhurave apo veprimtarive të tyre të ligjshme.

11. Ky konkluzion i gjykatës, bazohet në këto akte dhe prova:

a) Vendim për regjistrimin e procedimit pasuror, i datës xxxx, nga i cili rezulton që, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, xxx, me datë xxx, ka regjistruar procedimin pasuror që rrjedh nga procedimi penal nr. xxx, datë xxx, i prokurorisë së rrethit gjyqësor, xxx, në ngarkim të shtetasve H.M. dhe E.M.

12. b) Vendim, nr. xxxx, datë xxxx, i gjykatës së rrethit gjyqësor, xxx, për vendosjen e sekuestros preventive, nga i cili rezulton se, kjo gjykatë ka vendosur sekuestron preventive, për të gjitha asetet financiare (shuma në para) të shtetasve E.M. dhe H.M., të ndodhura në llogaritë e tyre bankare, në bankat xxx, xxx Bank, xxx dhe xxx Bank.

13. c) Urdhër për regjistrimin e procedimit penal, i datës xxx, nga i cili rezulton se, prokuroria e rrethit gjyqësor, xxx, ka vendosur të regjistrojë procedimin penal për veprën penale të: “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*”, të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.

14. ç) Urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, i datës xxx, nga i cili rezulton se, prokuroria e rrethit gjyqësor, xxx, ka vendosur të regjistrojë emrat e shtetasve H.M. dhe E.M., si persona që iu atribohet vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.

15. d) Kërkesë për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve kompetente të xxx, e datës xxx, nga e cila rezulton se, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, xxx, është kërkuar ndihmë juridike autoriteteve kompetente xxx, në lidhje me veprimtarinë ekonomike, financiare dhe shkeljet e mundshme penale, të kryera nga shtetasit E.M. dhe K.M.

16. dh) Shkresë nr. xxx xxx.xxx/xxx, datë xxx e Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol xxx, nga e cila rezulton se, sipas informacionit të dhënë nga Interpol xxx, në datë xxx, është arrestuar shtetasi K.H.M., i cili, është djali i të paditurit H.M. dhe vëllai i të paditurit E.M., në posedim të një sasive prej xxx gramë lëndë narkotike, kokainë.

17. e) Informacion i policisë gjyqësore, i datës xxx, nga i cili rezulton që, shtetasi E.M., për një periudhë dy vjeçare, xxx xxx-xxx xxx, ka kryer transaksione bankare, në shumën xxx euro, si dhe shtetasi H.M., për këtë periudhë, ka kryer transaksione bankare në shumën xxx euro.

18. ë) Shkresë e autoriteteve gjyqësore xxx, me nr. xxx/xx, datë xxx, ardhur në përgjigje të letërporosisë së dërguar nga autoritetet gjyqësore xxx, në bazë të të cilës rezulton që, shtetasi K.M. është arrestuar në xxx, me datë xxx, në posedimin e një sasive prej rreth xxx kilogramë kokainë.

19. f) Shkresë nr. xxx Prot, datë xxx e Unionit Financiar xxx, në të cilën janë pasqyruar transfertat e parave të kryera nga shtetasit K.M., E.M. dhe H.M.

20. g) Kthim përgjigje, e datës xxx e bankës xxx Bank, nga e cila rezulton që, shtetasi H.M.M., ka hapur llogari pranë kësaj banke dhe shuma e depozituar në këtë llogari, në ditën e kthimit të përgjigjes, është xxx euro, si dhe shtetasi E.H.M. ka hapur llogari pranë kësaj banke dhe shuma e depozituar në këtë llogari, në ditën e kthimit të përgjigjes, është xxx euro.

21. gj) Shkresë e bankës xxx Bank, me nr. xxx, Prot, datë xxx, në të cilën tregohen lëvizjet bankare të kryera në këtë bankë prej shtetasve E.H.M., H.M.M. dhe H.M.M., ku, bashkëngjitur kësaj shkrese janë dërguar të gjitha lëvizjet bankare që kanë kryer këta shtetas, nga të cilat rezulton se ata kanë depozituar shuma të konsiderueshme parash në euro.

22. h) Shkrese me nr. xxx, datë xxx e xxx Bank, nga e cila rezulton

që shtetasi E.M. ka të depozituar pranë kësaj banke, shumën prej xxx euro.

23. i) Shkresë me nr. xxx Prot, datë xxx, e xxx Bank, nga e cila rezulton se, shtetasi E.H.M., është mbajtës i tre llogarive bankare në këtë bankë, si dhe bashkëngjitur kësaj shkresë është edhe tabela e transaksioneve bankare, deri më datë xxx, nga e cila rezulton që, ky shtetas ka kryer lëvizje bankare, në euro, në shuma të konsiderueshme.

24. j) Shkresë nr. xxx, datë xxx e xxx Bank, nga e cila rezulton që, shtetasi E.M, ka katër llogari në këtë bankë, ku në dy prej tyre ka të depozituar shuma të konsiderueshme parash në euro.

25. k) Shkresë nr. xxx Prot, datë xxx, e xxx Bank, nga e cila rezulton që, shtetasi E.M. ka pranë kësaj banke katër llogari bankare, si dhe nga tabelat bashkëngjitur kësaj shkresë, rezulton se, ky shtetas ka kryer transaksione bankare pranë kësaj banke ,në shuma të konsiderueshme parash, në euro.

26. l) Shkresë e bankës xxx Bank, me nr. xxx Prot, datë xxx, nga e cila rezulton që, shtetasi E.H.M. ka llogari bankare të hapur pranë kësaj banke, si dhe ka kryer transaksione financiare në vlera të konsiderueshme prash, në euro.

27. ll) Shkresë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. xxx Prot, datë xxx, nga e cila rezulton që, shtetasit H.M.M., H.M.M., K.H.M. dhe G. Sh.M., nuk figurojnë të regjistruar në Regjistrin Tregtar, si subjekte tregtare, person fizik apo juridik.

28. m) Vendim nr. xxx, datë xxx i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, xxx, nga i cili rezulton se, mbi bazën e kërkesës së prokurorisë pranë kësaj gjykate, është vendosur sekuestrimi i pasurive të mëposhtme:

- shuma prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit H.M.M.;
- shuma prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxx euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxx euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxx (xxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxx, në bankën “xxx Bank”, në emër të shtetasit E.H.M.;
- shuma prej xxxx (xxxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në bankën “xxxx Bank”, në emër të shtetasit E. H. M. .

29. Duke i bërë një vlerësim dhe analizë ligjore akteve dhe provave të mësipërme, gjykata çmon se, nga ana e paditësit, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për pjesën e pasurisë që kërkon të konfiskohet, u provua pjesa e saj e barrës së provës që ligji nr. 10192, datë

03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, i ngarkon asaj, duke arritur paditësi në këtë gjykim që të provojë:

i. që për të paditurit H. M. dhe E. M. ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie që, kanë kryer një vepër penale nga ata që parashikon neni 3 i ligjit dhe konkretisht, rezultoi e provuar që ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie që, të paditurit kanë kryer veprën penale të: “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal;

ii. paditësi arriti që të provojë që të paditurit H. M. dhe E. M. , zotërojnë pasuri që nuk i përgjigjen, në mënyrë të dukshme, nivelit të të ardhurave apo veprimtarive të tyre të ligjshme.

30. Duke u nisur nga fakti që nga ana e paditësit, prokurorisë në rastin konkret, u plotësua barra e provës që i ngarkon ligji i posaçëm nr. 10192, datë 03.12.2009, gjykata çmon të argumentojë, në këtë pjesë të vendimit, nëse, të paditurit H. M. dhe E. M. , arritën që të provojnë pjesën e tyre të barrës së provës, pra, nëse arritën të provojnë orgjinën e ligjshme të pasurisë që kërkohet të konfiskohet, barrë prove kjo e vendosur, në mënyrë të shprehur, nga pika 3 e nenit 21 të ligjit të mësipërm, në të cilin parashikohet:

“3. Barra e provës, për të vertetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit pasuria e të cilit i kërkohet konfiskimi”.

31. Për të provuar origjinën e ligjshme të pasurisë për të cilën ishte kërkuar konfiskimi, të paditurit H. M. dhe E. M. paraqitën disa akte shkresore, në gjuhën italiane, të përkthyer dhe të noterizuara, si dhe të legalizuara me apostile, sipas formës së kërkuar nga ligji, të cilët përfaqësonin aktin e themelimit të një shoqërie binznesi privat familjar, i cili rezultoi të jetë krijuar nga shtetasi K. M. , djali i të paditurit H. M. dhe vëllai i të paditurit E. M. , me datë xxxx, si edhe bilancet e kësaj shoqërie, për vitet 2005, deri në vitin 2012, si dhe dokumente të ndryshme financiare që, tregonin veprimtarinë ekonomike të të paditurve, si persona fizikë.

32. Mbi bazën e kërkesës së bërë nga të paditurit, gjykata mori si provë edhe një

akt ekspertimi kontabël, ku, ekspertja në mendimin e saj me shkrim, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga palët, si dhe nga gjykata, në lidhje me bilancet e paraqitura nga të paditurit për veprimtarinë ekonomike të shoqërisë, si dhe veprimtarinë ekonomike të kryer nga të paditurit si persona fizik, për periudhën 2003-2012, si dhe bazuar në aktin e ekspertimit me shkrim, si dhe në shtesën e aktit të ekspertimit, nga ekspertja u konkludua se, për të gjithë periudhën 2003-2012, në bazë të dokumentacionin të vënë në dispozicion nga të paditurit, fitimi neto i tyre, është në vlerën xxxx (xxxx) euro.

33. Mbi bazën e pyetjes së bërë nga palët dhe gjykata, ekspertja në aktin e ekspertimit me shkrim dhe në shtesën e këtij akti, ka përcaktuar se, shpenzimet e jetesës për të paditurit H. M. dhe E. M. dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së tyre, kanë qenë xxxx (xxxx) euro, duke konkluduar eksperti që, fitimi neto i realizuar nga të paditurit, fitim neto i shoqërisë familjare, plus fitim neto nga veprimtaria si persona fizik e të paditurve, që është në vlerën prej xxxx(xxxx) euro, minus shpenzimet për jetesë të të paditurve, që janë në shumën xxxx (xxxx) euro, shuma është e barabartë me xxxx (xxxx) euro.

34. Kësaj shume duhet t'i zbritet shuma prej xxxx (xxxx) eurosh, si shumë e transferuar jashtë shtetit nga të paditurit, duke mbetur përfundimisht, shuma prej xxxx (xxxx) euro, për të cilën të paditurit kanë arritur që të provojnë origjinën e ligjshme të saj, dhe për pasojë për këtë shumë prokurori ka kërkuar kthimin e saj të paditurve, ndërsa për pjesën tjetër, konkretisht për shumën prej xxxx (xxxx) euro, prokurori ka kërkuar konfiskimin e saj, me arsyetimin që të paditurit nuk arritën që të provojnë origjinën e ligjshme të kësaj pasurie.

35. Gjykata, bazuar në konkluzionet e aktit të ekspertimit kontabël, si dhe në të gjitha aktet dhe provat e tjera, çmon se të paditurit H. M. dhe E. M., arritën që të provonin, vetëm pjesërisht origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre, konkretisht, për shumën prej xxxx (xxxx) euro, ndërsa, për pjesën tjetër të pasurisë që kërkohet të konfiskohet, që është shuma prej xxxx (xxxx) euro, ata nuk arritën që të provojnë origjinën e ligjshme të kësaj pasurie, prandaj kjo shumë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar, do të konfiskohet dhe të kalojë në të ardhurat e shtetit.

36. Si pjesë të këtij vendimi gjykata e gjen me vend të bëjë edhe pretendimet e ngritura nga përfaqësuesit e posaçëm të të paditurve, gjatë gjykimit dhe në

diskutimin e tyre përfundimtar me shkrim, ku një nga pretendimet e tyre ishte fakti që, lëvizjet bankare që kanë bërë të paditurit në Itali, të cilat së bashku me bilancet e shoqërisë, kapin vlerën totale prej xxxx euro, duhet të konsiderohet si provim prej tyre origjinës së ligjshme të pasurisë së tyre, me arsyetimin sipas mbrojtjes që: "...dokumentet bankare janë prova të pakontestueshme, të hartuara nga organet kompetente dhe në formën e kërkuar nga ligji... që nuk lënë dyshim për ligjshmërinë dhe vertetësinë e këtyre të ardhurave ...".

37. Këtë pretendim të përfaqësuesve të të paditurve gjykata e gjen të pabazuar, sepse, fakti që të paditurit i kanë transferuar paratë e tyre nëpërmjet bankave, nuk prezumon që origjina e tyre është e ligjshme, përkundrazi, në kuptim të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, të paditurit kanë detyrimin që të provojnë origjinën e ligjshme të pasurive që kërkohen të konfiskohen, duke treguar aktivitetin ekonomik, tregtar ose financiar konkret, nga e cila ka ardhur kjo pasuri, gjë që nuk mund të provohet, thjesht, me faktin e depozitimit të parave në bankë.

38. Në vlerësim të kësaj gjykate, është krejt ndryshe të tregosh që paratë që kërkohen të konfiskohen janë të depozituara në bankë, dhe krejt ndryshe të provosh origjinën e ligjshme të këtyre parave, pasi fakti që paratë janë depozituar në bankë, nuk provon origjinën e tyre të ligjshme, të paditurit për të provuar origjinën e ligjshme të këtyre parave, duhet të tregojnë burimin e ligjshëm nga kanë ardhur këto para, gjë që në këtë gjykim, për pjesën e parave që prokurori kërkoi që të konfiskohen, të paditurit nuk arritën që ta provojnë.

39. Pretendimi tjetër i bërë nga përfaqësuesit e të paditurve, sipas të cilëve kredia e marrë nga të paditurit me datë xxxx, në shumën prej xxxx euro, gabimisht, nga ana e ekspertës, nuk është llogaritur si fitim neto i shoqërisë, çmohet nga gjykata si i pabazuar, pasi në bazë të rregullave të ekonomisë së tregut, të sqaruara nga ana e ekspertës edhe në aktin e ekspertimit, kredia nuk mund të konsiderohet, asnjëherë, si fitim neto, pasi që të konsiderohet si e tillë, duhet të jemi para kontratës së dhurimit dhe jo kontratës së kredisë dhe kjo shumë kredie, në kohën që është marrë, konsiderohet që nuk ndikon në pakësimin ose shtimin e pasurisë, pasi ajo është një shumë e marrë, e cila do të kthehet pas, madje së bashku me interesat dhe duke qenë se është marrë për zhvilluar një aktivitet ekonomik, që nuk dihet sesi do të rezultojë, në të ardhmen, me fitim apo humbje, për këtë arsye, vlera e saj në shtimin e pasurisë, duhet të konsiderohet zero.

40. Pretendimi tjetër i bërë nga ana e përfaqësuesve të të paditurve, sipas të cilit nuk duhet të zbriten nga fitimi neto, shuma e llogaritur për shpenzimet jetike të të paditurve dhe familjes së tyre, pasi kjo shumë është zbritur nga ekspertja, kur ka bërë zbritjen e shpenzimeve tek bilancet e shoqërisë, gjendet nga gjykata i pabazuar, sepse, mbrojtja ngatërron ose nuk kupton që, shpenzimet e llogaritura në bilancet e shoqërisë, janë shpenzime që lidhen me aktivitetin ekonomik të

saj, e cila përbëhet nga të ardhurat dhe shpenzimet, ndërsa, shpenzimet për jetesën e të paditurve, janë kategori tjetër shpenzimesh, të cilat duhet të zbriten pasi të jenë zbritur shpenzimet nga bilanci i shoqërisë dhe nga fitimi neto i shoqërisë dhe i aktivitetit tjetër ekonomik të të paditurve, si persona fizikë, duhet të hiqen apo të zbriten shpenzimet për jetesën e të paditurve dhe familjes së tyre.

41. Edhe pretendimi tjetër përfaqësuesve të të paditurve, sipas të cilit nga fitimi neto i realizuar prej tyre, nuk duhet të zbritet tranferta bankare prej xxxx eurosh, e dërguar jashtë shtetit prej të paditurve, është i pabazuar, pasi në kushtet kur kjo shumë parash, është tjetërsuar prej tyre, duke kaluar në pronësi të tretëve, ajo nuk ndodhet më në pronësi të të paditureve dhe për pasojë duhet të hiqet nga fitimi neto i realizuar prej tyre.

42. Pretendimi i fundit i bërë nga përfaqësuesit e të paditureve ka të bëjë me veprimin në kohë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, i ndryshuar, duke pretenduar se, ky ligj nuk ka fuqi prapavepruese dhe në kushtet kur sipas përfaqësuesit të të paditurve nga ana e prokurorit është deklaruar se pasuria që kërkohet të konfiskohet, është krijuar pas janarit të vitit 2010, duke pretenduar të paditurit se, për periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit, i bie barra e provës prokurorit që të provojë që origjina e pasurisë është e paligjshme.

43. Në lidhje me këtë pretendim gjykata çmon se, ai është i pabazuar në prova dhe ligj, pasi siç parashikon edhe pika 4 e nenit 3 të ligjit, e cituar edhe nga përfaqësuesi i të paditurve në diskutimin përfundimtar, në të cilën thuhet se: ***“4. Ky ligj zbatohet edhe për pasurinë e personave, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale sipas këtij ligji”***, ligji në fjalë, ka fuqi prapavepruese, vetëm në rastet përjashtimore, kur ka dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie, se pasuritë janë vënë gjatë veprimtarisë kriminale të parashikuar nga ky ligj.

44. Në rastin konkret, gjykata çmon dhe vlerëson se, duke iu referuar akteve dhe provave të shqyrtuara dhe të cituara në këtë vendim, më lart, ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara, në indicie, që të paditurit H. M. dhe E. M., pasurinë prej xxxx (xxxx) euro, për të cilën ata nuk arritën që të provojnë origjinën e ligjshme të saj, e kanë vënë nga veprimtari kriminale, të realizuar para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 dhe për pasojë, është detyrimi i tyre dhe jo i prokurorit, që të provojnë origjinën e ligjshme të kësaj pasurie, dhe në kushtet kur ato nuk arritën që ta bënin një gjë tillë, kjo pasuri do të konfiskohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 3, 5, 7, 14, 15 deri në 22, 23, 24, 28-38 e vijues, të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009, “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” dhe nenit 299/b të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

1. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të shumave të llogarive bankare të mëposhtëme:

1.1. Të shumës xxxx (xxxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit H. M. M.;

1.2. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro, që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M., e cila si llogari, në total, ka vlerën xxxx (xxxx) euro;

1.3. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2. Kthimin të paditurve të shumave të llogarive bankare të mëposhtëme.

2.1. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx x, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2.2. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2.3. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. 0100-415569-001, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2.4. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2.5. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M.;

2.6. Të shumës prej xxxx (xxxx) euro që ndodhet në llogarinë me nr. xxxx, në Bankën xxxx Bank, në emër të shtetasit E. H. M., e cila si llogari, në total, ka vlerën xxxx (xxxx) euro.

3. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Shërbimi Përmbarimor, ndërsa për Administrimin e pasurive z. K. Xh., i cili është Administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara,

pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të paditureve H. dhe E. M., në përpjestim me pjesën e pranuar të padisë.

5. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

6. U shpall në Tiranë, sot me datë 15.06.2015.

**SEKRETARE
LAVDIE HYSAJ**

**GJYQTAR
LUAN HASNEZIRI**

